



Qeveria e Republikës së Maqedonisë
Agjencioni për përkrahje financiare na bujqësi dhe zhvillim rural

Në bazë të nenit 14 paragrafi 2 (a) nga Ligji për ratifikim të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit i Bashkësive Evropiane për rregullat për bashkëpunim në aspekt të ndihmës financiare prej KE të Republikës së Maqedonisë dhe zbatimin e ndihmës sipas komponentit V (IPARD) prej instrumentit për ndihmë parahyrëse "Gaz. zyrtare e RM " nr. 165/2008) dhe në bazë të Pjesës V paragrafi (5) prej Programit për shfrytëzimin e mjeteve prej Instrumentit për ndihmë parahyrëse për zhvillim rural të Bashkimit Evropian (IPARD) për periudhën 2007-2013 ("Gaz. zyrtare e RM" nr. 83/2009),

Agjencioni për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural

më 31 mars të vitit 2012 shpall

THIRJE PUBLIKE nr.01/2012

për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve prej
IPARD Programit 2007-2013

Agjencioni për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural (në tekstin e më tutjeshëm: Agjencioni) si institut kompetent dhe organ kontraktues për zbatimin e marrëveshjes të Instrumentit për ndihmë parahyrëse për zhvillim rural të UE (IPARD) u bën thirrje të gjithë të interesuarve persona fizik dhe juridik prej Republikës së Maqedonisë të dorëzojnë kërkesa për shfrytëzimin e mjeteve prej IPARD Programit 2007-2013 për masat në vijim:

Masa 101 – Investime në ekonomitë bujqësore me qëllim të ristrukturimit dhe mbindërtimit të tyre për arritjen e standardeve të Bashkimit evropian

Masa 103 - Investime për përpunim dhe marketing për prodhimet bujqësore dhe të peshkut me ristrukturimin dhe mbindërtimin e tyre për arritjen e standardeve të Bashkimit Evropian

Masa 302 – Diverzifikim dhe zhvillim të aktiviteteve ekonomike rurale

1. Përkrahja financiare për këtë Thirrje publike është e përbërë prej 75% mjete të siguruara nga komponenta e pestë e Instrumentit për ndihmë parahyrëse për zhvillim rural të Unionit Evropian (IPARD), në përputhshmëri me



**Instrument për ndihmë parahyrëse të Bashkimit Evropian
për zhvillim rural (IPARD) 2007-2013**



Marrëveshjen financiare shumvjecare 2007-2011 dhe 25% mjete të siguruara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

2. Mjetet financiare sipas kërkesave individuale jepen si përkrahje financiare e pakthyeshme (grant) në vlerë prej 50% nga vlera e shpenzimeve të pranueshme, gjegjësisht 55% për kërkesë të dorëzuar nga bartësi i ekonomisë bujqësore jo më i vjetër se 40 vjet nga dita e fillimit të realizimit të investimit të mjeteve sipas masës 101.

3. Afati i fundit për dorëzimin e kërkesës është 15.05.2012.

4. Marrja e formularëve dhe udhëzimeve:

Formularët e duhur prej „Kërkesë për shfrytëzimin e mjeteve prej IPARD Programit 2007-2013“ si dhe „Udhëzimi për shfrytëzuesit e mjeteve prej IPARD Programit 2007-2013“ në të cilin janë të përfshira të gjitha informatat për kriteret, kushtet për pranueshmëri të projekteve dhe kushteve për financim dhe informata të tjera të cilat janë të domosdoshme për përgatitjen e kërkesës për shfrytëzimin e mjeteve të IPARD Programit 2007-2013, Udhëzim për përgatitje të Planit afarist, Udhëzim për gjetje (nxjerrje) të dokumentacionit të domosdoshëm nga institucionet kompetente dhe informacione tjera të nevojshme në versionin elektronik mund të merren në ueb-adresën e Agjencionit: www.ipardpa.gov.mk.

Formularët në formë të shtypur prej kërkesës për shfrytëzimin e mjeteve të IPARD Programit 2007-2013, dhe Udhëzimit për shfrytëzuesit e mjeteve të IPARD Programit 2007-2013 mund të merren drejtpërdrejt në Agjencion në adresën:

**Agjencioni për përkrahje financiare në bujqësinë dhe zhvillimin rural,
bul. 3-ta Makedonska Brigada nr. 20 (ndërtesa Makedonija Tabak, bloku C)
1000 Shkup**

dhe në qendrat më të afërta rajonale ose njësitet punuese të **Agjencionit për nxitje të zhvillimit në bujqësi** çdo ditë pune prej **orës 8:30 deri ora 16:30** . (Lista e qendrave rajonale ose njësiteve punuese të Agjencionit për nxitje të zhvillimit në bujqësi me të dhënat për kontakt janë të shpallura në ueb-adresën www.ipardpa.gov.mk

5. Mënyra e dorëzimit të kërkesës:

Kërkuesit duhet të dorëzojnë Kërkesë për shfrytëzimin e mjeteve prej IPARD Programit 2007-2013 për masa individuale, Plan afarist, i përgatitur në bazë të Udhëzimit për përgatitje të Planit afarist dhe dokumentacionin shoqërues siç është e cekur në Kërkesën për shfrytëzimin e mjeteve prej IPARD Programit 2007-2013. Informata më detale për kërkesat specifike për pranueshmëri janë të cekur në *Udhëzimin për shfrytëzuesit e mjeteve të IPARD Programit 2007-2013*.

Kërkesa për shfrytëzimin e mjeteve prej IPARD Programit 2007-2013 dhe Plani afarist përgatiten në gjuhën maqedone.

Kërkesat e plotësuara për shfrytëzimin e mjeteve prej IPARD Programit 2007-2013 së bashku me Planin afarist dhe dokumentacionin e duhur të plotë dorëzohen në zarf të mbyllur me shenjë në pjesën e përparme të zarfit lartë në qoshin e majtë “MOS E HAP” për Thirrje publike IPARD numër 01/2012 dhe shënimin e shifrës të masës për të cilën e dorëzon kërkesën. Kërkesa mund të dorëzohet me postë si dërgesë e rekomanduar apo personalisht në arkivin e Agjencionit.

Vërejtje: Kërkesa për shfrytëzimin e mjeteve prej IPARD Programit 2007-2013 ,Plani afarist dhe dokumentacioni i dorëzuar NUK KTHEHEN. Për shkak të kontrolit të realizuar në teren nga ana e Agjencionit është e nevojshme që kërkuesi të ketë kopje nga dokumentacioni i përgjithshëm i dorëzuar në Agjencion.

Informata në detaje në kontakt tel. (02) 3097-460 ose në kontakt e-mail adresën: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk dhe në ueb-faqen: www.ipardpa.gov.mk.



**Drejtme të përgjithshme për përgatitjen e kërkesës së
Shpalljes publike nr. 01/2012**

1.	Qëllimet e përgjithshme të IPARD Programit 2007-2013
	Qëllimi i IPARD Programit 2007-2013 është nëpërmjet masave të përshtatshme për përkrahje të zhvillimit bujqësor dhe rural që të përmirësohet konkurrimi i prodhimeve bujqësore dhe sektori bujqësor-ushqimor nëpërmjet dakordimit të tyre me standardet e Bashkimit evropian dhe arritje të ambientit jetësor të qëndrueshëm dhe zhvillim socio-ekonomik të hapësirave rurale përmes nxitjes së aktiviteteve ekonomike dhe rritjen e mundësive për punësim, nëpërmjet prioritetëve në vijim: - përmirësim i konkurrencës për ekonomi bujqësore të qëndrueshme dhe kapacitete bujqësore-ushqimore të nën-sektoreve të caktuara nëpërmjet investimeve të dedikuara për përmirësimin e infrastrukturës teknologjike dhe të tregut me qëllim që të rrit vlerën e shtuar të prodhimeve bujqësore që të arrihen standardet e Bashkimit evropian për cilësi, korrektësi shëndetësore, siguri shëndetësore, mirëqenien e kafshëve dhe standardet për mbrojtjen e mjedisit. - përmirësimin e cilësisë së jetës të popullatës rurale, rritjen e të ardhurave në mjediset rurale dhe krijimin e mundësive për punësime të reja përmes zhvillimit dhe diverzifikimit të aftësive ekonomike të ekonomive bujqësore që të zvogëlohet pabarazia ndërmjet rajoneve dhe në krahasim me mjediset urbane.
2.	Prioritete për dhënien e përkrahjes financiare
	Në pajtim me qëllimet e IPARD Programit 2007-2013, prioritetet kryesore për përkrahjen financiare janë në vijim: a) Në pajtim me Boshtin Prioritar 1 – Përmirësimin e efikasitetit të tregut dhe implementimin e standardeve të Bashkimit evropian: Masa 101 – Investime në ekonomitë bujqësore me qëllim të ristrukturimit dhe mbindërtimit për arritjen e standardeve të Bashkimit Evropian Masa 103 - Investime për përpunim dhe marketing për prodhimet bujqësore dhe të peshkut me ristrukturimin dhe mbindërtimin e tyre për arritjen e standardeve të Bashkimit Evropian b) Në pajtim me –Boshtin prioritar 3 – Zhvillim të ekonomisë në mjediset rurale: Masa 302 - Diverzifikim dhe zhvillim të aktiviteteve ekonomike rurale
3.	Lënda dhe kushtet për shfrytëzimin e përkrahjes financiare për masën 101
	Përkrahja financiare për masën 101 është dedikuar për prodhimet bujqësore në sektorët prioritarë vreshtari (1011), pemëtari (1012), kopshtari (1013), kultivimin e bagëtisë qumështore për prodhim primar të qumështit të papërpunuar (1014) dhe kultivimin e bagëtisë dhe shpendarisë për shumim për prodhim të mishit (1015). Grupet e investimeve të sektorëve prioritarë u dedikohen llojeve të investimeve në vijim:
Shifra	Lloji i investimit
10111	Përtrirja e fidanëve ekzistues të hardhive
10121	Përtrirja e fidanëve ekzistues të pemëve
10131	Ndërtimi dhe përtrirja e serave prej plasmasi (në përjashtim të serave në formë tuneli)
10132	Ndërtimi dhe përtrirja e serave ekzistuese prej qelqi
10133	Ndërtimi dhe përtrirja e objekteve për aktivitetet pas vjeljes në serat ekzistuese prej plasmasi dhe



	qelqi (në përjashtim të serave në formë tuneli)																																																																												
10134	Modernizimi i prodhimitarisë së perimeve në ambient të hapur																																																																												
10141	Ndërtim/përtrirje të objekteve për ruajtjen e lopëve, dhenve dhe dhive që milen																																																																												
10142	Furnizim me pajisje për mjelje, ftohje dhe deponim të qumështit																																																																												
10151	Ndërtim/përtrirje të objekteve për ruajtjen e derrave për shumim																																																																												
10152	Vendosje e kapaciteteve të reja të shpendarisë në ekonomitë bujqësore për ruajtjen e zogjëve dhe modernizimin e atyre ekzistuese																																																																												
3.1.	Kërkuesit për shfrytëzim të mjeteve nga masa 101 mund të jenë ekonomi bujqësore, të cilët janë të regjistruar në Regjistrin qendror të ekonomive bujqësore në MBPE në pajtim me Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural („Gaz. zyrtare e RM“ nr. 49/10), Ligji për plotësimin e ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural („Gaz. zyrtare e RM“ nr. 53/11), si: a) Prodhues individual bujqësor – persona fizik (pronarë të ekonomive bujqësore familjare apo bartës të ekonomisë bujqësore- bujk individual të cilët merren me bujqësi në emër të vet dhe llogari të vet si dhe i cili është pronar i pronës bujqësore apo ka të drejtë për shfrytëzimin e pronës bujqësore të ekonomisë bujqësore në bazë juridike; b) Person juridik, i themeluar në pajtim me Ligjin për shoqatat tregtare („Gaz .zyrtare e RM “ nr. 28/04, 84/05, 25/07, 87/08,42/10,48/10), Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit te shoqërive tregtare (nr. 24/11) dhe është i regjistruar në Regjistrin qendror për veprimtari bujqësore, [sipas Klasifikimit nacional të veprimtarive („Gaz .zyrtare e RM “ nr. 147/08)]; c) Kooperativa të themeluara në pajtim me Ligjin për kooperativa („Gaz. zyrtare e RM“ nr. 54/02, 84/05) të cilët janë të regjistruar për veprimtari bujqësore dhe janë të regjistruara si të tilla në Regjistrin qendror [sipas Klasifikimit nacional të veprimtarive („Gaz. zyrtare e RM “ nr. 147/08)]; ç) Persona tjerë fizik dhe juridik, të cilët fillojnë me veprimtari bujqësore përderisa i plotësojnë kushtet e veçanta për madhësinë e kapacitetit prodhues të kërkuesve sipas sektorëve prioritarë. 2) Madhësia e kapaciteteve prodhuese të ekonomive bujqësore: <table><tr><th rowspan="2">Shfrytëzues</th><th rowspan="2">Sektor me prioritet</th><th rowspan="2">Grupet e investimeve</th><th rowspan="2">Njësia masa</th><th colspan="2">Madhësia e kapaciteteve të pranueshme</th></tr><tr><th>Min.</th><th>Maks.</th></tr><tr><td colspan="6">Prodhuesi individual bujqësor</td></tr><tr><td rowspan="8"><i>Bujqësi bimore</i></td><td colspan="5">1011 Fidanë hardhi</td></tr><tr><td></td><td>10111</td><td>Ha</td><td>0.5</td><td>20</td></tr><tr><td colspan="5">1012 Kopsht pemësh</td></tr><tr><td></td><td>10121</td><td>Ha</td><td>0.5</td><td>15</td></tr><tr><td colspan="5">1013 Kopshtari</td></tr><tr><td>- sera plasmasi</td><td>10131;10133</td><td>ha</td><td>0.3</td><td>3</td></tr><tr><td>- sera qelqi</td><td>10132; 10133;</td><td>ha</td><td>0.1</td><td>2.5</td></tr><tr><td>- ambient të hapur</td><td>10134</td><td>ha</td><td>0.5</td><td>15</td></tr><tr><td rowspan="4"><i>Blegtori</i></td><td colspan="5">1014 Prodhimtari primare të qumështit të papërpunuar</td></tr><tr><td>- lopë qumshtore</td><td>10141; 10142</td><td>kokë</td><td>10</td><td>100</td></tr><tr><td>- dhi qumështore</td><td>10141; 10142</td><td>kokë</td><td>50</td><td>500</td></tr><tr><td>- dhen qumështor</td><td>10141; 10142</td><td>kokë</td><td>300</td><td>3,000</td></tr></table>	Shfrytëzues	Sektor me prioritet	Grupet e investimeve	Njësia masa	Madhësia e kapaciteteve të pranueshme		Min.	Maks.	Prodhuesi individual bujqësor						<i>Bujqësi bimore</i>	1011 Fidanë hardhi						10111	Ha	0.5	20	1012 Kopsht pemësh						10121	Ha	0.5	15	1013 Kopshtari					- sera plasmasi	10131;10133	ha	0.3	3	- sera qelqi	10132; 10133;	ha	0.1	2.5	- ambient të hapur	10134	ha	0.5	15	<i>Blegtori</i>	1014 Prodhimtari primare të qumështit të papërpunuar					- lopë qumshtore	10141; 10142	kokë	10	100	- dhi qumështore	10141; 10142	kokë	50	500	- dhen qumështor	10141; 10142	kokë	300	3,000
Shfrytëzues	Sektor me prioritet					Grupet e investimeve	Njësia masa	Madhësia e kapaciteteve të pranueshme																																																																					
		Min.	Maks.																																																																										
Prodhuesi individual bujqësor																																																																													
<i>Bujqësi bimore</i>	1011 Fidanë hardhi																																																																												
		10111	Ha	0.5	20																																																																								
	1012 Kopsht pemësh																																																																												
		10121	Ha	0.5	15																																																																								
	1013 Kopshtari																																																																												
	- sera plasmasi	10131;10133	ha	0.3	3																																																																								
	- sera qelqi	10132; 10133;	ha	0.1	2.5																																																																								
	- ambient të hapur	10134	ha	0.5	15																																																																								
<i>Blegtori</i>	1014 Prodhimtari primare të qumështit të papërpunuar																																																																												
	- lopë qumshtore	10141; 10142	kokë	10	100																																																																								
	- dhi qumështore	10141; 10142	kokë	50	500																																																																								
	- dhen qumështor	10141; 10142	kokë	300	3,000																																																																								





	1015 Prodhim të mishit				
	- derra për shumim	10151	kokë*	2,000	8,000
	- derra	10151	kokë	40	100
	- zogj	10152	zogj*	5,000	30,000
Kooperativat bujqësore, persona juridik që merren me bujqësi, apo persona juridik që hyjnë në aktivitete bujqësore					
<i>Bujqësi bimore</i>	1011 Fidanë hardhi				
		10111	ha	0.5	50
	1012 Kopsht pemësh				
		10121	ha	0.5	30
	1013 Fidanë perimesh				
	- sera plasmasi	10131;10133	ha	1.0	8
	- sera qelqi	10132;10133	ha	1.5	6
	- ambient të hapur	10134	ha	0.5	30
<i>Blegtori</i>	1014 Prodhime të qumështit				
	- lopë qumështore	10141; 10142	kokë	15	150
	- dhi qumështore	10141; 10142	kokë	80	800
	- dhen qumështor	10141; 10142	kokë	500	8,000
	1015 Prodhimi i mishit				
	- derra	10151	Kokë¹	2,000	30,000
	-derra	10151	kokë	40	400
	- zogj	10152	Zogj¹	5,000	60,000
¹ Qarkullim vjetor					
3) Personi përgjegjës/bartësi i ekonomisë bujqësore:					
– duhet të ketë të kryer minimum shkollim të mesëm apo – të posedojë çertifikatë për trajnim e botuar nga institucionet relevante për mbajtjen e trajnimit sipas Ligjit për arsim shkencor (profesional) dhe trajnim ("Gaz. Zyrtare e RM" nr. 71/06; 117/08; 148/09), Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për arsim profesional dhe trajnim ("Gaz. Zyrtare e RM" nr. 17/11) së bashku me listën e tematikave nga trajnimi të cilat janë të lidhura me investimin e propozuar² – nuk mund të jetë më i vjetër se 59 vite pleqëri (për burra) dhe 57 vite pleqëri (për gra) në ditën e fillimit të realizimit të investimit, duke pasur parasysh kufirin për pensionim prej 64 vite për burra dhe 62 për gra në pajtim me rregullat nga Ligji për sigurim pensional dhe invalidor "Gaz. zyrtare e RM" nr. 80/93, 14/95, 71/96, 32/97, 24/00, 96/00, 5/01, 85/03, 50/04, 4/05, 84/05, 101/05 , 70/06), 153/07, 152/08, 161/08, 81/09,156/09,83/10, 127/10, 156/10, 24/11, 51/11, 11/12). – personi përgjegjës i personit juridik patjetër të jetë i punësuar në kohë të pacaktuar tek personi juridik- kërkues. Në rastet kur personi juridik ka më tepër persona përgjegjës , personi përgjegjës i cili është parashtrues i Kërkesës për shfrytëzim të mjeteve nga IPARD Programi 2007-2013 duhet të jetë i punësuar në kohë të pacaktuar tek personi juridik – kërkues.					
² Vërejtje: Kërkesit të cilët nuk i plotësojnë kushtet për kualifikime arsimore duhet të deklarojnë se se pajtohen të ndjekin trajnim të organizuar në kuadër të Programit për përkrahje financiare në zhvillim rural para se të parashtrojnë kërkesë për pagesë përfundimtare.					
3.2.	Lartësia e financimit sipas masës 101				



	Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme është 5 000 euro (307.521,00 në kundërvlerë denari) Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme nuk mund ta tejkalojë: – 200 000 euro (12.300.840,00 në kundërvlerë denari) nga shpenzimet e përgjithshme të pranueshme të investimeve qëllimi i të cilave është që të arrihen standardet relevante të Bashkësisë Evropiane të lidhura me investimin e parashtruar pas realizimit të investimit apo – 400 000 euro (24.601.680,00 në kundërvlerë denari) nga shpenzimet e përgjithshme të pranueshme të investimeve qëllimi i të cilave është pajtimi i plotë i veprimtarisë prodhuese të ekonomive bujqësore me standardet relevante të Bashkësisë Evropiane pas realizimit të investimit . Kufizimet tjera financiare të cilat do të zbatohen: a) Për përtirirjen e mbjelljeve shumëvjeçare: – Shpenzimet e pranueshme të investimeve në furnizimin e pajisjeve bujqësore (në përjashtim të shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme për investim në sistemin për ujitje) nuk duhet të kalojnë 35% prej shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme, të parapara në kuadër të buxhetit të projektit; b) Për ndërtim dhe rikonstruim të serave prej plasmasi (me përjashtim të folive manuale (me dorë) apo serave ekzistuese prej qelqi Shpenzimet e përgjithshme të pranueshme të investimeve në furnizimin e pajisjeve bujqësore (në përjashtim të shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme për investim në sistemin për ujitje) nuk duhet të kalojnë 25% të shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme të parapara në kuadër të buxhetit të projektit, c) Për modernizim të kultivimit të perimeve në ambiente të hapura Shpenzimet e përgjithshme të pranueshme të investimeve në furnizimin e pajisjeve bujqësore (në përjashtim të shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme për investim në sistemin për ujitje) nuk duhet të tejkalojnë 25% prej shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme të parapara në kuadër të buxhetit të projektit, ç) Për ndërtim dhe rikonstruim të objekteve për ruajtjen e blegtorisë: – Shpenzimet e përgjithshme të pranueshme të investimeve në pajisje për ruajtjen e ushqimit për bagëti dhe pajisje të specializuara për prodhimin e ushqimit për bagëti nuk duhet të tejkalojnë 45% prej shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme (me përjashtim të shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme) të parapara në kuadër të buxhetit të projektit, derisa projekti i përgjithshëm ka për qëllim rikonstruimin e objekteve shoqëruese për deponim dhe ruajtjen e ushqimit të bagëtisë dhe ahurit; – Shpenzimet e përgjithshme të pranueshme të investimeve në pajisje të specializuara për prodhimin e ushqimit për bagëti nuk duhet të kalojnë 25% prej shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme për investime (me përjashtim të shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme) të parapara në kuadër të buxhetit të projektit, derisa projekti i përgjithshëm ka për qëllim rikonstruimin e objekteve për ruajtjen e derrave për shumim, përfshirë dhe renovimin e objekteve për deponim të ushqimit për bagëti; Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për ko-financim të një shfrytëzuesi nuk mund të kalojë 530 000 euro në kuadër të periudhës financiare 2007-2013. Një shfrytëzues mund të dorëzojë më shumë kërkesa për shfrytëzimin e mjeteve prej IPARD Programit 2007-2013, me kusht që të mos e kalon vlerën maksimale të shpenzimeve të pranueshme për financim dhe nëse projektet e mëparshme janë të përfunduara me sukses, gjegjësisht përkrahja financiare është plotësisht e paguar.
4.	Lënda dhe kushtet për shfrytëzimin e përkrahjes financiare për masën 103 Përkrahja financiare për masën 103 është e dedikuar për sektorin e bujqësisë-ushqimit në sektoret me prioritet venëtar (1031), përpunim dhe deponim të pemëve dhe perimeve (1032), përpunim të qumështit dhe prodhim të produkteve të qumështit (1033), prodhim të mishit të freskët dhe përpunimet e mishit (1034). Grupet e investimeve të sektoreve me prioritet u dedikohen llojeve të investimeve në vijim:



shifra	Lloji i investimit																																												
10311	Investime për furnizim me pajisje për përmirësimin e cilësisë së venës																																												
10321	Investime për ndërtimin dhe përtirjen e objekteve për vendosjen dhe modernizimin e qendrave blerëse të pemëve dhe perimeve																																												
10322	Investime për furnizim të pajisjeve për përmirësim dhe modernizim të teknologjive për prodhim në kapacitetet për përpunimin e pemëve dhe perimeve																																												
10331	Investime për ndërtimin dhe përtirjen e objekteve për vendosjen dhe modernizimin e qendrave për grumbullim të qumështit																																												
10332	Investime për modernizimin dhe freskim teknologjik të kapaciteteve të specializuara për përpunimin e qumështit																																												
10341	Investime për vendosjen e kapaciteteve për thertore për shpendtari																																												
10342	Modernizim dhe freskim teknologjik të linjave ekzistuese të thertoreve për lopë, derra dhe shpezë																																												
10343	Investime në kapacitetet për thertore dhe kapaciteteve për përpunimin e mishit për mbrojtjen e ambientit jetësor																																												
4.1.	Kërkues për shfrytëzim të mjeteve nga masa 103 mund të jenë persona juridik të qëndrueshëm ekonomikisht të themeluar në rangun e tregtarit të vogël apo të mesëm³ dhe janë të regjistruar në Regjistrin qendror në pajtim me Ligjin për shoqëri tregtare ("Gaz. Zyrtare e RM" nr. 28/04, 84/05, 25/07, 87/08, 42/10, 48/10), Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit të shoqërive tregtare (nr. 24/11), pa kapital shtetëror në strukturën pronaredhe të cilët janë të regjistruar si të obliguar të TVSh-së sipas Ligjit për TVSh ("Gaz. Zyrtare e RM" nr. 44/99, 59/99, 86/99, 11/00, 8 / 01, 21/03, 19/04, 33/06, 101/06, 114/07, 103/08, 114/09, 133/09, 95/10, 102/10, 24/11, 135/11). ³Vërejtje: Personat juridik të cilët janë në rangun e tregtarëve të mëdhenj, përkatësisht punësojnë deri 250 persona dhe të cilët kanë qarkullim vjetor i cili nuk tejkalon 50 milionë euro dhe / ose bilanc të përgjithshëm vjetor të gjendjes i cili nuk tejkalon 43 milionë euro mund të paraqiten si kërkues përderisa investimi i është dedikuar një pjese të personit juridik dhe është i dedikuar për përputhshmëri të plotë me standardet relevante të Unionit Evropian. Kërkues për shfrytëzim të mjeteve nga masa 103- lloji i investimit 10321 dhe 10331 mund të jenë edhe kooperativat bujqësore të qëndrueshme ekonomikisht të themeluara në pajtim me Ligjin për kooperativa ("Gaz. Zyrtare e RM" nr 54/02, 84/05) dhe të cilët janë të regjistruar në Regjistrin qendror me veprimtari bujqësore sipas Klasifikimit nacional të veprimtarive ("Gaz. Zyrtare e RM" nr. 147/08) 2) Madhësia e kapaciteteve prodhuese: <table><tr><th rowspan="2">Sektor me prioritet</th><th rowspan="2">Shfrytëzues</th><th rowspan="2">Grupa e investimeve</th><th rowspan="2">Njësia masa⁴</th><th colspan="2">Madhësia e kapaciteteve të pranueshme</th></tr><tr><th>Min.</th><th>Maks.</th></tr><tr><td colspan="6">1031 Venëtari</td></tr><tr><td></td><td></td><td>10311</td><td>hl</td><td>1,500</td><td>55,000</td></tr><tr><td colspan="6">1032 Përpunimi i pemëve dhe perimeve:</td></tr><tr><td>- kapacitet për grumbullim /kapacitet për ftohje dhe deponim</td><td></td><td>10321</td><td>ton</td><td>500</td><td>3,000</td></tr><tr><td>- tharje</td><td></td><td>10322</td><td>ton</td><td>40</td><td>500</td></tr><tr><td>- ngrirje</td><td></td><td>10322</td><td>ton</td><td>500</td><td>5,000</td></tr></table>	Sektor me prioritet	Shfrytëzues	Grupa e investimeve	Njësia masa ⁴	Madhësia e kapaciteteve të pranueshme		Min.	Maks.	1031 Venëtari								10311	hl	1,500	55,000	1032 Përpunimi i pemëve dhe perimeve:						- kapacitet për grumbullim /kapacitet për ftohje dhe deponim		10321	ton	500	3,000	- tharje		10322	ton	40	500	- ngrirje		10322	ton	500	5,000
Sektor me prioritet	Shfrytëzues					Grupa e investimeve	Njësia masa ⁴	Madhësia e kapaciteteve të pranueshme																																					
		Min.	Maks.																																										
1031 Venëtari																																													
		10311	hl	1,500	55,000																																								
1032 Përpunimi i pemëve dhe perimeve:																																													
- kapacitet për grumbullim /kapacitet për ftohje dhe deponim		10321	ton	500	3,000																																								
- tharje		10322	ton	40	500																																								
- ngrirje		10322	ton	500	5,000																																								



			10322	ton	500	5,000
	-konservim					
	1033 Përpunim të qumështit dhe prodhimeve të qumështit:					
	- kapacitet për grumbullim /kapacitet për ftohje dhe deponim		10331	litër në ditë	1,500	30,000
	- kapacitet për përpunim		10332	litër në ditë	5,000	100,000
	1034 Prodhimet e mishit					
	Kapacitet për therrje	-shpezë	10341;10342; 10343	Kokë në ditë	5,500	30,000
		-lopë	10342; 10343	Kokë në ditë	15	150
		-derra	10342; 10343	Kokë në ditë	20	300
		-qengja	10343	Kokë në ditë	50	4,000
	Përpunim të mishit	- kapacitet për përpunim	10343	ton	2,000	25,000
⁴kapacitete të instaluar: - për venë, e shprehur në hektolitra për vit - për pemë dhe perime, e shprehur në ton pemë dhe perime të freskëta, kapacitet vjetor për grumbullim ose në ton prodhim i gatshëm nga përpunimi i pemëve dhe perimeve të freskëta - për qumësht dhe prodhime të qumështit, e shprehur në litra për ditë, kapacitet i grumbullimit apo litra në ditë, kapacitet për përpunim të lëndës së parë - për therrje, e shprehur për kokë në ditë - për përpunimin e mishit, e shprehur në ton për vit 3) Personi përgjegjës i personit juridik: – duhet të posedojë shkollim profesional në pajtim me Rregulloren për mënyrën e kontrollit për dituri dhe mënyrën për dhënie të vërtetimeve për dituri themelore të fituar për higjienë të ushqimit dhe mbrojtje të mjedisit jetësor („Gaz. zyrtare e RM“ nr. 118/2005), – nuk mund të jetë më i vjetër se 59 vite pleqëri (për burra) dhe 57 vite pleqëri (për gra)në ditën e fillimit të realizimit të investimit, duke pasur parasysh kufirin për pensionim prej 64 vite për burra dhe 62 për gra në pajtim me rregullat nga Ligji për sigurim pensional dhe invalidor “Gaz. zyrtare e RM“ nr. 80/93, 14/95, 71/96, 32/97, 24/00, 96/00, 5/01, 85/03, 50/04, 4/05, 84/05, 101/05 , 70/06), 153/07, 152/08, 161/08, 81/09, 156/09, 83/10, 127/10, 156/10, 24/11, 51/11, 11/12). – personi përgjegjës i personit juridik patjetër të jetë i punësuar në kohë të pacaktuar tek personi juridik- kërkues. Në rastet kur personi juridik ka më tepër persona përgjegjës , personi përgjegjës i cili është parashtrues i Kërkesës për shfrytëzim të mjeteve nga IPARD Programi 2007-2013 duhet të jetë i punësuar në kohë të pacaktuar tek personi juridik – kërkues.						
4.2.	Lartësia e financimit sipas masës 103 Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme është 15 000 euro (922.563,00 në kundërvlerë denari) Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme nuk mund ta kalojë: – 400 000 euro (24.601.680,00 në kundërvlerë denari) nga shpenzimet e përgjithshme të pranueshme të investimeve qëllimi i së cilave është që të arrihen standardet relevante të Bashkësisë Evropiane pas realizimit të investimeve apo – 800 000 euro (49.203.360,00 në kundërvlerë denari) nga shpenzimet e përgjithshme të pranueshme të investimeve qëllimi i së cilave është pajtimi i plotë i kapaciteteve prodhuese me standardet relevante të Bashkësisë Evropiane të lidhura me investimin e parashtruar pas realizimit të investimit.					



	– 3.000.000 euro (184.512.600,00 në kundërvlerë denari) nga shpenzimet e përgjithshme të pranueshme të investimeve të cilat janë dedikuar për vendosjen e kapaciteteve të reja për thertore për shpezë plotësisht të përputhura me standardet e Bashkësisë Evropiane. Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për ko-financim të një shfrytëzuesi nuk mund të tejkalojë 1.100.000 euro në kuadër të periudhës financiare 2007-2013. Një shfrytëzues mund të dorëzojë më shumë kërkesa për shfrytëzimin e mjeteve prej IPARD Programit 2007-2013, me kusht që të mos e kalojë vlerën maksimale të shpenzimeve të pranueshme për financim dhe nëse projektet e mëparshme janë të përfunduar me sukses, gjegjësisht përkrahja financiare është plotësisht e paguar.
5.	Lënda dhe kushtet për shfrytëzimin e përkrahjes financiare për masën 302
	Përkrahja financiare për masën 302 është dedikuar për popullatën rurale për investime në sektorët me prioritet: përkrahje të mikro ndërmarrjeve në mjediset rurale (3021) dhe investime për promovimin e aktiviteteve për turizmit rural (3022). Investimet patjetër të realizohen në mjediset rurale (të shënuara në Bashkëngjitje 11: Lista e rrethinave rurale në Republikën e Maqedonisë nga Udhëzuesi për shfrytëzues të mjeteve nga IPARD Programi 2007-2013). Grupet e investimeve të sektorëve me prioritet u dedikohen llojeve të investimeve në vijim:
shifra	Lloji i investimit
30211	Investim për vendosjen e kapaciteteve përpunuese të ekonomive bujqësore dhe jashtë ekonomive bujqësore
30212	Investim për vendosjen dhe modernizimin e qendrave blerëse për kërpudha dhe bimë shëruese/aromatike dhe bimë për erëza, dhe kapacitete për kultivimin e kërpudhave
30213	Investim për vendosjen e punëtorive të veprimtarive të zejeve tradicionale dhe punëtori për mirëmbajtjen e mekanizmit bujqësor
30221	Investim për rikonstruimin e objekteve të ekonomive bujqësore të dedikuara për turizëm rural, dhe të plotësuara me kapacitete rekreuese
30222	Investime për ndërtimin e objekteve hotelierike, vendosje në ambient të hapur (kampe) dhe kapacitete rekreuese
